



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE

KOMISIONI I MBROJTJES NGA RREZATIMET

Nr. 12/4 prot

Tiranë, më 08.01.21.

**Lënda:** Procedurat e aplikimit për aprovim import/eksport, transport, transfer/tranzit të burimeve të rrezatimit jonizues si dhe vlerësimi i dokumentacionit nga ana e ZMR për këto kategori.

Aplikimi për aprovim import/eksport, transport, transfer/tranzit të burimeve të rrezatimit jonizues mbështetet në ligjin Nr. 8025, datë 9.11.1995 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese” i ndryshuar, Ligjin Nr.118/2012 “Për transportin e mallrave të rrezikshme”, VKM Nr.158 datë 13.02.2008 “Për import-eksport të burimeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr. 815 datë 16.11.2016 “Për transportin e sigurtë të materialeve radioaktive”, VKM Nr.404 datë 18.06.2014 “Për rregullat bazë të instalimeve radiologjike në mjekësi”, udhëzuesin Nr. 134, datë 12.04.2011 për import eksportin dhe tranzitin e burimeve radioaktive të kategorive 1 dhe 2 në Republikën e Shqipërisë, si dhe Kodin e drejtimit për sigurinë dhe sigurimin e burimeve radioaktive Nr.1388 datë 14.04.2004.

Personat juridike/fizike dhe tregtare paraprakisht duhet të jenë të pajisur me licencë nga KMR, për të kryer veprimtarinë e import/export transport, tranzit dhe transferim të burimeve të rrezatimit jonizues.

Aplikimi për aprovim import/eksport, transport, transfer/tranzit të burimeve të rrezatimit jonizues bëhet pranë ZMR tek personi i ngarkuar për këtë qëllim, ose në adresën elektronike zyrtare të ZMR dhe/ose siç e specifikon legjislacioni i sistemeve elektronike dhe/ose me postë normale me dokumente origjinale.

Personi përgjegjës pret personin fizik/juridik, ose personin e autorizuar nga përfaqësuesi ligjor i subjektit, ose verifikon emailin e ardhura në adresën zyrtare dhe në varësi të informacionit që kërkohet, i vë në dispozicion procedurën bashkë me formatin sqarues siç përcaktohet në shtojcat I, II, III, IV bashkëngjitur këtij materiali për plotësim të mëtejshëm.

Kërkesa zyrtare për aprovim import/eksport, transport, transfer/tranzit të burimeve të rrezatimit jonizues bashkë me dokumentacionin shoqëruar dorëzohet në zyrën e protokollit në ZMR nga përfaqësuesi ligjor i subjektit që kërkon të pajiset me aprovim import/eksport, transport, transfer/tranzit të burimeve të rrezatimit jonizues, ose nga një person i autorizuar prej tij. Dokumentacioni mund të dorëzohet dhe në version elektronik nga adresat elektronike zyrtare të personit juridik e fizik të deklaruar në QKB ose të deklaruar në ZMR në momentin e licensimit për ushtrimin e veprimtarisë me burime të rrezatimit jonizues. Në zbatim të urdhrin Nr.37 datë 10.06.2019, Zyra e protokollit ose dosja elektronike i dërgohet brenda ditës për procedurë të mëtejshme personit përgjegjës të ngarkuar për këtë proces në ZMR, duke njoftuar dhe kryetarin e ZMR.



Nëse për arsye të ndryshme personi përgjegjës nuk gjendet në ZMR, paraprakisht kjo detyrë i ngarkohet në mënyrë të përkohshme një prej specialistëve të ZMR.

Për t'u pajisur me aprovim import-eksport, transport/tranfer/tranzit të burimeve radioaktive të kategorisë 1 dhe 2, subjekti duhet ti drejtohet ZMR-së jo më vonë se 45 ditë pune përpara parashikimit të import/eksport/transport/transfer/tranzit të burimeve radioaktive të kësaj kategorie. Vlerësimi i dokumentacionit nga specialisti i ZMR-së për këtë kategori, duhet të marrë në konsideratë dhe konfirmimet përkatëse nga pikat e kontaktit sipas kodit të drejtimit nga vendet e origjinës.

Për t'u pajisur me aprovim import-eksport, transport/tranfer/tranzit të burimeve radioaktive të kategorisë 3, subjekti duhet ti drejtohet ZMR-së jo më vonë se 30 ditë pune përpara parashikimit të import/eksport/transport/transfer/tranzit të burimeve radioaktive të kësaj kategorie. Vlerësimi i dokumentacionit nga specialisti i ZMR-së për këtë kategori kërkon një periudhë 10 ditë pune.

Për t'u pajisur me aprovim import-eksport, transport/tranfer/tranzit të burimeve radioaktive të kategorisë 4, subjekti duhet ti drejtohet ZMR-së jo më vonë se 15 ditë pune përpara parashikimit të import/eksport/transport/transfer/tranzit të burimeve radioaktive të kësaj kategorie. Vlerësimi i dokumentacionit nga specialisti i ZMR-së për këtë kategori kërkon një periudhë 5 ditë pune.

Për t'u pajisur me aprovim import-eksport, transport/tranfer/tranzit të burimeve radioaktive të kategorisë 5, subjekti duhet ti drejtohet ZMR-së jo më vonë se 7 ditë pune përpara parashikimit të import/eksport/transport/transfer/tranzit të burimeve radioaktive të kësaj kategorie. Vlerësimi i dokumentacionit nga specialisti i ZMR-së për këtë kategori kërkon nga 3 ditë pune.

Për lëndët radioaktive për përdorime në mjekësinë bërthamore me periode përgjysmimi të vogël, koha e përpunimit të dokumentacionit është 2 ditë pune.

Për t'u pajisur me aprovim import-eksport të gjeneratorëve me rreze X, subjekti duhet ti drejtohet ZMR-së jo më vonë se 10 ditë pune përpara parashikimit të import/eksport të kësaj kategorie. Vlerësimi i dokumentacionit nga specialisti i ZMR-së për këtë kategori kërkon një periudhë 5 ditë pune.

Vlerësimi nga ana e specialistit për këtë proces fillon nga momenti që dokumentacioni është plotësuar në mënyrë korrekte dhe në përputhje me kërkesat legjislative.

I gjithë dokumentacioni për aprovim import/eksport, transport, transfer/tranzit të burimeve të rrezatimit jonizues duhet të jetë i vulosur dhe i sigluar në cdo faqe nga personi fizik/juridik tregëtar sic përcaktohet në licencë dhe QKB, ose nga një person i autorizuar me shkrim prej tij.

Pas vlerësimit të dokumentacionit për aprovimet sipas kategorive të mësipërme dhe nëse janë plotësuar të gjitha kërkesat rregullatore, plotësohet formati përkatës mbi dokumentacionin e dorëzuar në ZMR, dhe i dorëzohet subjektit nëpërmjet zyrës së protokollit brenda afatit ligjor.

SEKRETARI  
Rustem PACI

KRYETARI  
Ogerta MANASTIRLIU



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E SHËNDETËSISË**  
**KOMISIONI I MBROJTJES NGA RREZATIMET**

---

**Aprovim IMPORT / EKSPORT**  
**PËR BURIME RADIOAKTIVE**  
**Kategoria 1 dhe 2**

Nr \_\_\_\_\_ Datë \_\_\_\_\_

Në mbështetje të ligjit “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese ”, Nr. 8025 , datë 9.11.1995,i ndryshuar , VKM mbi “Import-eksportet e burimeve te rrezatimit jonizues” nr 158 datë 13/02/2008, Rregullores për “Kategorizimin e burimeve radioaktive” Nr.9, datë 7.1.2010 dhe rregulloreve përkatëse;

Personit Fizik Juridik (emri, adresa)

\_\_\_\_\_

me përfaqësues Z/Znj

\_\_\_\_\_

I lejohet

Të Importojë \_\_\_\_\_

Të Eksportojë \_\_\_\_\_

Radionuklidi

\_\_\_\_\_

Aktiviteti për çdo radionuklid

\_\_\_\_\_

Data Prodhimit

\_\_\_\_\_

Forma Fizike /Kimike

\_\_\_\_\_

Prodhuesi (Kompania)

\_\_\_\_\_

Modeli/Seria/ Certifikata e cilësisë

\_\_\_\_\_

Enti Përdorues

\_\_\_\_\_

Qëllimi i përdorimit

\_\_\_\_\_

Vendi nga importohet / ku eksportohet (emri adresa)

Nr dhe data e faturës

\_\_\_\_\_

Data e përafërt e Importit/Eksportit

\_\_\_\_\_

Pika e hyrjes/daljes

\_\_\_\_\_

Ky dokument dorëzohet origjinal në pikat doganore dhe është i vlefshëm 2 muaj nga data e lëshimit. Mbas importimit /eksportimit, personi Fizik /Juridik është i detyruar brenda 1 jave të njoftojë ZMR me shkrim për kryerjen e veprimeve në dogane.

U kërkuar nga

\_\_\_\_\_

U miratua në Mbledhjen e KMR

Nr \_\_\_\_\_ Datë \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_  
K R Y E T A R I



I. 1. FORMATI SHPJEGUES NË LIDHJE ME DOKUMENTACIONIN QË DUHET TË PLOTËSOHET NGA SUBJEKTI PËR T'U PAJISUR ME APROVIM IMPORTI-EKSPORTI KATEGORIA 1 DHE 2

Kërkesa zyrtare për t'u pajisur me aprovim importi/eksporti për burimet radioaktive kategoria 1 dhe 2 duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

Kërkesa duhet të plotësohet nga personi Fizik Juridik (emri, adresa) sic pershkruhet në regjistrin e QKB dhe/ose në licencën e miratuar nga KMR për ushtrimin e veprimtarisë me burime të rrezatimit jonizues

Të sqarohen të dhënat e Radionuklidit që do të importohet ose eksportohet (emri dhe formula e Radionuklidit)

Të sqarohet aktiviteti për çdo radionuklid, dhe të paraqitet aktiviteti total në Bq

Të plotësohet informacioni në lidhje me datën e prodhimit të burimit duke përfshirë: data/muaji/viti dhe aktivitetin fillestar

Të sqarohet forma Fizike /Kimike e radionuklidit: e ngurte, e lëngët ose e gaztë, si dhe formula kimike

Të sqarohet kush është kompania prodhuese dhe nr i licencës në vendin e origjinës

Të plotësohet informacioni mbi modelin dhe nr serial të burimit radioaktiv, si dhe të bashkëngjitet certifikata e cilesisë e sigluar nga personi i cili e ka kryer dhe datën përkatëse. Të shtohet dhe Nr i licencës ose certifikatës së njohjes nga ana e autoriteteve për këtë veprimtari

Të plotësohet informacioni se kush është subjekti i cili do të përdorë burimin radioaktiv

Të shpjegohet qëllimi se për çfarë do të përdoret burimi në; diagnosticim, terapi, industri etj.

Të plotësohet informacioni në lidhje me vendin nga importohet ose ku do eksportohet burimi radioaktiv (emri adresa)

Të përcaktohet destinacioni fillestar dhe final

Të përcaktohet nr dhe data e faturës. Fatura duhet të bashkëngjitet kërkesës

Të përcaktohet data e përafërt e Importit ose Eksportit data/muaji/viti

Të përcaktohet pika e hyrjes ose e daljes të burimit radioaktiv që do të thotë pika ky hyn në territor jo pika doganore.

SHTOJCA II. FORMATI I APROVIMIT PËR IMPORT/EKSPORT PËR BURIME  
RADIOAKTIVE KATEGORIA 3,4 DHE 5



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E SHËNDETËSISË**  
**KOMISIONI I MBROJTJES NGA RREZATIMET**  
**ZYRA E MBROJTJES NGA RREZATIMET**

---

**Aprovim IMPORT / EKSPORT**  
**PER BURIME RADIOAKTIVE**  
**Kategoria 3,4,5**

Nr \_\_\_\_\_ Datë \_\_\_\_\_

Në mbështetje të ligjit “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese ”, Nr. 8025 , datë 9.11.1995, i ndryshuar , VKM mbi “Import-eksportet e burimeve te rrezatimit jonizues” nr 158 datë 13/02/2008, Rregullores për “Kategorizimin e burimeve radioaktive” Nr.9, datë 7.1.2010 dhe rregulloreve përkatëse;

Personit Fizik Juridik (emri, adresa)

\_\_\_\_\_

me përfaqësues Z/Znj

\_\_\_\_\_

I lejohet

Të Importojë \_\_\_\_\_

Të Eksportojë \_\_\_\_\_

Radionuklidi

\_\_\_\_\_

Aktiviteti për çdo radionuklid

\_\_\_\_\_

Data Prodhimit

\_\_\_\_\_

Forma Fizike /Kimike

\_\_\_\_\_

Prodhuesi (Kompania)

\_\_\_\_\_

Modeli/Seria/ Certifikata e cilësisë

\_\_\_\_\_

Enti Përdorues

\_\_\_\_\_

Qëllimi i përdorimit

---

Vendi nga importohet / ku eksportohet (emri adresa)

---

Nr dhe data e faturës

---

Data e përafërt e Importit/Eksportit

---

Pika e hyrjes/daljes

---

Ky dokument dorëzohet origjinal në pikat doganore dhe është i vlefshëm 2 javë nga data e lëshimit. Mbas importimit /eksportimit, personi Fizik /Juridik është i detyruar brenda 1 javë të njoftojë ZMR me shkrim për kryerjen e veprimeve në doganë.

U kërkua nga

---

U përpunua nga

---

---

K R Y E T A R I

II. 1. FORMATI SHPJEGUES NË LIDHJE ME DOKUMENTACIONIN QË DUHET TË  
PLOTËSOHET NGA SUBJEKTI PËR T'U PAJISUR ME APROVIM IMPORTI-EKSPORTI  
KATEGORIA 3,4 DHE 5

Kërkesa zyrtare për t'u pajisur me aprovim importi/eksporti për burimet radioaktive kategoria 3,4 dhe 5 duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

Kërkesa duhet të plotësohet nga personi Fizik Juridik (emri, adresa) sic pershkruhet ne regjistrin e QKB dhe/ose në licencën e miratuar nga KMR për ushtrimin e veprimtarisë me burime të rrezatimit jonizues

Të sqarohen të dhënat e Radionuklidit që do të importohet ose eksportohet (emri dhe formula e Radionuklidit)

Të sqarohet aktiviteti për çdo radionuklid, dhe të paraqitet aktiviteti total në Bq

Të plotësohet informacioni në lidhje me datën e prodhimit të burimit duke përfshirë: data/muaji/viti dhe aktiviteti fillestar

Të sqarohet forma Fizike /Kimike e radionuklidit: e ngurte, e lenget ose e gaztë, si dhe formula kimike

Të sqarohet kush është kompania prodhuese dhe nr i licencës në vendin e origjinës

Të plotësohet informacioni mbi modelin dhe nr serial të burimit radioaktiv, si dhe të bashkëngjitet certifikata e cilesise e sigluar nga personi i cili e ka kryer dhe datën përkatëse. Të shtohet dhe nr i licencës/certifikatës së njohjes nga ana e autoriteteve për këtë veprimtari

Të plotësohet informacioni se kush është subjekti i cili do të përdorë burimin radioaktiv

Të shpjegohet qëllimi se për çfarë do të përdoret burimi në; diganostike, terapi, industri etj.

Të plotësohet informacioni në lidhje me vendin nga importohet ose ku do eksportohet burimi radioaktiv (emri adresa)

Të përcaktohet destinacioni fillestar dhe final

Të përcaktohet nr dhe data e faturës. Fatura duhet ti bashkëngjitet kërkesës

Të përcaktohet data e përafërt e Importit ose Eksportit data/muaji/viti

Të përcaktohet pika e hyrjes ose e daljes të burimit radioaktiv që do të thotë pika ky hyn në territor jo pika doganore.

Shënim: Plotësimi i pikave të aprovimit të importit/eksportit për kategoritë 1,2,3,4 dhe 5 nuk e përjashton subjektin nga plotësimi i kërkesave të tjera rregullatore sic përcaktohet në legjislacionin përkatës.



SHTOJCA III FORMATI I APROVIMIT PËR IMPORT/EKSPORT PËR GJENERATORË ME  
RREZE X

**Aprovim IMPORT / EKSPORT  
PËR GJENERATORË ME RREZE X**

Nr \_\_\_\_\_ Datë \_\_\_\_\_

Në mbështetje të ligjit "Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese " nr 8025 , datë 9.11.1995,i ndryshuar, VKM mbi "Import- eksportin e burimeve të rrezatimit jonizues në Republikën e Shqipërisë" Nr 158, datë 13 Shkurt 2008 dhe rregulloreve përkatëse

Personit Fizik/Juridik

Me perfaqësues Z/Znj \_\_\_\_\_

I lejohe

Të Importojë \_\_\_\_\_

Të Eksportojë \_\_\_\_\_

Pajisje me reze x

Modeli/Seria \_\_\_\_\_

Tensioni maksimal (Opsional,përdorimi) \_\_\_\_\_

Data e prodhimit dhe certifikata e cilësisë e dy viteve të fundit nga data e importimit

Kompania destinacion \_\_\_\_\_

Vendi nga importohet / ku eksportohet \_\_\_\_\_

Nr faturës \_\_\_\_\_

Data e përafërt e Importit/Eksportit \_\_\_\_\_

Pika e hyrjes/Daljes \_\_\_\_\_

Kjo leje dorëzohet origjinal në pikat doganore dhe është e vlefshme 2 javë nga data e lëshimit. Mbas importimit /eksportimit, personi Fizik /Juridik është i detyruar brenda 1 jave të njoftojë ZMR me shkrim për kryerjen e veprimeve në doganë dhe destinacionin e pajisjes.

U kërkuar nga \_\_\_\_\_

U përpunua nga \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_  
K R Y E T A R I

### III.1. FORMATI SHPJEGUES NË LIDHJE ME DOKUMENTACIONIN QË DUHET TË PLOTËSOHET NGA SUBJEKTI PËR T'U PAJISUR ME APROVIM IMPORTI-EKSPORTI GJENERATORË ME RREZE X

Kërkesa zyrtare për t'u pajisur me aprovim importi/eksporti për gjeneratorë me rreze X të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

Kërkesa duhet të plotësohet nga personi Fizik Juridik (emri, adresa) sic përshkruhet në regjistrin e QKB dhe/ose në licencën e miratuar nga KMR për ushtrimin e veprimtarisë me burime të rrezatimit jonizues.

Të plotësohet informacioni mbi modelin, nr serial të gjeneratorit me rreze X i cili do të importohet ose eksportohet, i cili të jetë në përputhje me dokumentacionin që shoqëron pajisjen

Të plotësohet informacioni mbi tensioni maksimal i cili duhet të shprehet në kV

Të plotësohet informacioni mbi datën e prodhimit si dhe mbi certifikatën e cilësisë e dy viteve të fundit nga data e importimit.

Të paraqitet certifikata e cilësisë së kontrollit teknik në përputhje me VKM Nr. 404 datë 18.6.2014, i cili duhet të jetë e sigluar, të mbajë datën e siglimit, të dhënat teknike të pajisjes/ve që do të importohet, nr përkatës, adresën e personit që ka kryer testet dhe nr e licencës ose njohjen nga autoritetet përkatëse nëse ka. Certifikata e kontrollit teknik duhet të paraqitet në origjinal, ose e noterizuar. Për të mos krijuar vonesa, gjatë procesit të aplikimit për aprovim importi, të paraqitet një kopje e certifikatës së kontrollit teknik të sigluar e noterizuar ose të deklarohe se pas kryerjes së importit do të dërgohet në ZMR brenda 1 jave dokumenti origjinal. Ky dokument duhet të verifikohet nga Autoritetet Doganore në momentin e importit. Mos dërgimi i certifikatës origjinale do të penalizojë subjektet.

Të sqarohet emri i kompanisë që do e përdorë dhe nr i licencës së saj miratuar nga autoriteti rregullator

Të plotësohet informacioni mbi vendin nga do të importohet ose eksportohet gjeneratori me rreze X, si dhe informacioni mbi kompaninë prodhuese.

Të përcaktohet nr i faturës dhe data dhe një kopje e faturës ti bashkëngjitet kërkesës.

Të përcaktohet data e përafërt e importit ose eksportit të gjeneratorit me rreze X (data/muaji/viti)

Të plotësohet informacioni mbi pikën e hyrjes/ ose daljes që nënkupton: pika e hyrjes ose daljes nga shqiperia/ dhe ose pika doganore.

Shënim: Të gjithë subjektet që kryejnë import të gjeneratorëve me rreze X për të tretë, përpara importimit të pajisjes duhet të sigurohen që subjekti ku do të shitet pajisjet me rreze X është i licensuar nga KMR për përdorimin e tyre. Nëse subjekti nuk disponon licencë për përdorim, subjektet janë të detyruar t'i magazinonjë deri në momentin e pajisjes së tyre nga KMR me licencë përkatëse.

Gjatë procesit për aprovim importi, importuesi duhet të deklarojë me shkrim dhe të saktësohet subjekti i licensuar ku do të dërgohet pajisja me rreze X. Nqs do të magazinohet të deklarohe me shkrim adresa e saktë e magazinës ku do të magazinohet pajisja.

SHTOJCA IV FORMATI I APROVIMIT PËR  
TRANSPORTIN/TRANSFERIMIN/TRANZITIN E BURIMEVE RADIOAKTIVE  
KATEGORIA 1, 2, 3, 4 dhe 5



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË  
KOMISIONI I MBROJTJES NGA RREZATIMET  
ZYRA E MBROJTJES NGA RREZATIMET  
**Aprovim TRANSPORTI PËR  
BURIME RADIOAKTIVE**

Nr \_\_\_\_\_ Datë \_\_\_\_\_

Në mbështetje të ligjit Nr.118/2012 “Per transportin e mallrave të rrezikshme ‘’, ligjit Nr.8025, datë 9.11.1995 “ Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese ’’, i ndryshuar , rregullores Nr. 815, datë 16.11.2016 “ Për transportin e sigurtë të materialeve radioaktive’’,si dhe rregulloreve të tjera përkatëse;

Personit Fizik Juridik(emri adresa) \_\_\_\_\_  
me përfaqësues Z. \_\_\_\_\_

I lejohet të transportojë me makinën me targë \_\_\_\_\_

Radionuklidi(et) \_\_\_\_\_

Aktiviteti total \_\_\_\_\_

Lloji i pakos. Aprovimi i paketimit \_\_\_\_\_

Emri Adresa e dërguesit \_\_\_\_\_

Emri adresa pritësit të lëndës \_\_\_\_\_

Forma kimike/fizike \_\_\_\_\_

Formën e posaçme \_\_\_\_\_

Klasifikimi i paketimit \_\_\_\_\_

Indeksi i transportit. \_\_\_\_\_

Numri i OKB \_\_\_\_\_

Për burimet e mbyllura të paraqitet çertifikata e cilësisë së burimit \_\_\_\_\_

Transporti do të kryhet nga \_\_\_\_\_

deri(destinacioni final) \_\_\_\_\_

Nr, data e faturës \_\_\_\_\_

Data ose periudha e përafërt e transportit \_\_\_\_\_

Ky dokument shoqëron transportin e burimeve radioaktive nga nisja deri në destinacionin final dhe është i vlefshëm 2 javë nga data e lëshimit. Mbas transportit të lëndëve radioaktive, personi fizik/juridik është i detyruar brënda 1 jave të njoftojë ZMR me shkrim për kryerjen e transportit dhe dorëzimin e lëndëve në destinacion.

U kërkua nga \_\_\_\_\_

U përpunua nga \_\_\_\_\_

K R Y E T A R I





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË

KOMISIONI I MBROJTJES NGA RREZATIMET  
ZYRA E MBROJTJES NGA RREZATIMET  
Aprovim TRANSFERIMI /TRAZITI PËR  
BURIME RADIOAKTIVE

Nr \_\_\_\_\_ Datë \_\_\_\_\_

Në mbështetje të ligjit Nr.118/2012 “Për transportin e mallrave të rrezikshme”, ligjit Nr.8025, datë 9.11.1995 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese ”, i ndryshuar, rregullores Nr. 815 , datë 16.11.2016 “ Për transportin e sigurtë të lëndëve radioaktive” si dhe rregulloreve të tjera përkatëse;

Personit Fizik Juridik(emri adresa) \_\_\_\_\_  
me përfaqësues Z. \_\_\_\_\_

I lejohet të transportojë me makinën me targë \_\_\_\_\_

Radionuklidi(et) \_\_\_\_\_

Aktiviteti total \_\_\_\_\_

Lloji i pakos. Aprovimi i paketimit \_\_\_\_\_

Emri Adresa e dërguesit \_\_\_\_\_

Emri adresa pritësit të lëndës \_\_\_\_\_

Forma kimike/fizike \_\_\_\_\_

Formën e posaçme \_\_\_\_\_

Klasifikimi i paketimit \_\_\_\_\_

Indeksi i transportit. \_\_\_\_\_

Numri i OKB \_\_\_\_\_

Për burimet e mbyllura të paraqitet çertifikata e cilesisë së  
burimit \_\_\_\_\_

Transporti do të kryhet nga \_\_\_\_\_

deri(destinacioni final) \_\_\_\_\_

Nr, data e faturës \_\_\_\_\_

Data ose periudha e përafërt e transferimi/ tranzitit \_\_\_\_\_

Ky dokument shoqëron transferim/ tranzitit e burimeve radioaktive nga nisja deri në destinacionin final dhe është i vlefshëm 2 javë nga data e lëshimit. Mbas transferim/ tranzitit të lëndëve radioaktive, personi fizik/juridik është i detyruar brënda 1 jave të njoftojë ZMR me shkrim për kryerjen e transferim/ tranzitit dhe dorëzimin e lëndëve në destinacion.

U kërkua nga \_\_\_\_\_

U përpunua nga \_\_\_\_\_

K R Y E T A R I

IV.1. FORMATI SHPJEGUES NË LIDHJE ME DOKUMENTACIONIN QË DUHET TË  
PLOTËSOHET NGA SUBJEKTI PËR T'U PAJISUR ME APROVIM  
TRANSPORTIN/TRANSFERIMIN/TRANZITIN E BURIMEVE RADIOAKTIVE  
KATEGORIA 1, 2, 3, 4 DHE 5

Kërkesa zyrtare për t'u pajisur me aprovim transporti/tranferimi/tranziti të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

Kërkesa duhet të plotësohet nga personi Fizik Juridik (emri, adresa) sic pershkruhet në regjistrin e QKB dhe/ose në licencën e miratuar nga KMR për ushtrimin e veprimtarisë me burime të rrezatimit jonizues.

Të jepet informacion në lidhje në lidhje me makinën që do të kryejë transportin/transferimin/tranzitin, Targa e makinës e cila duhet të jëtë e njëjtë me atë që është deklaruar në momentin e licensimit

Të jepet informacion në lidhje me Radionuklidi(et) që do të transportohen/transferohen/tranzit  
Të plotësohet informacioni mbi aktivitetin total në Bq i burimeve radioaktive

Të jepet informacion mbi llojin e pakos, aprovimin e paketimit dhe ti bashkangjitet kërkues dokumentacioni nga vendi i origjinës me këto të dhëna

Të përcaktohet emri dhe adresa e saktë e dërguesit

Të përcaktohet emri dhe adresa e saktë e pritësit të lëndës

Të përcaktohet Forma kimike/fizike e materialit radioaktiv (e lëngët, e ngurtë, e gazte si dhe formula kimike.

Të përcaktohet informacioni mbi formën e posaçme: e mbyllur apo e hapur

Të përcaktohet klasifikimi i paketimit sipas rregullores në fuqi dhe ti bashkëngjitet kërkesës dokumentacioni përkatës

Të plotësohet informacioni mbi Indeksën e transportit (IT) sic përcaktohet në dokumentat që shoqërojnë burimin

Të përcaktohet Numri i OKB, sipas standartit dhe dokumentacionit që shoqëron burimin.

Për burimet e mbyllura të paraqitet çertifikata e cilësisë së burimit, i cili është dokument që tregon testimin e burimit.

Të plotësohet informacioni mbi rrugën që do të kryejë burimi gjatë

transportit/transferimit/tranzitit nga pika e nisjes deri në destinacionin final.

Të plotësohet informacioni mbi Nr dhe datën e faturës dhe një kopje ti bashkëngjitet kërkesës.

Të përcaktohet data ose periudha e përafërt e transporti/transferimit/tranzitit: data/muaj/viti.

Në zbatim të rregullores Nr. 877, datë 30.10.2015 "Për sigurimin fizik të materialeve radioaktive" neni 9 të paraqitet plani i sigurimit fizik të matererialeve radioaktive për burimet radioaktive të kategorisë 1, 2 dhe 3.

Të paraqitet raport vlerësimi i dozës për publikun dhe punonjësve që do të kryejnë transportin e materialeve radioaktive të katëgorisë 1,2,3,4 dhe 5.